

STATUTI I SHOQERISE TREGTARE
“IMA PLANET 2018” sh.p.k



Neni 1

Emri

Emri i shoqerise eshte “ IMA PLANET 2018 ” sh.p.k

Neni 2

Forma

Forma e shoqerise eshte ajo e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar (“SHPK”), bazuar ligjin Nr. 129/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar sipas nenit 68 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008.

Shoqeria “IMA PLANET 2018” SHPK sh.p.k. zoterohet nga ortakët:

FRENK HODAJ dhe ANILA ÇELA te cilet nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkuara.

Neni 3

Data e themelimit

Shoqeria eshte themeluar me date 03.12.2018.

Neni 4

Ortakët

Ortak te shoqerise jane:

FRENK HODAJ i cili zoteron 51 % te kuotave te shoqerise, me gjeneralitet: atesia: Ilir, i datelindjes 23.08.1995 lindur ne Vlore dhe banues ne Rr. Ibrahim Rugova, Tirane, identifikuar me pasaporten me nr.J508231071, leshuar me date 26.12.2017,

ANILA ÇELA e cila zoteron 49 % te kuotave te shoqerise, me gjeneralitetet: atesia: Shefqet, e datelindjes 22.09.1974 lindur ne Polican, Skrapar dhe banues ne lagja Aqif Pasha, Elbasan, identifikuar me leternjoftimin me nr. Personal: H45922002N, leshuar me date 05.04.2011,

Neni 5

Selia

Selia e shoqerise eshte ne adresen: lagjia “Aqif Pasha” Elbasan, pall. 495/2, ap.1, Shk.1, Kati 3, Shqiperi. Pasuria me nr.7/440+1-1, Zona Kadastrale 8524.

Shoqeria mund te cele dhe seli te dyta , dege e filiale, perfaqesi dhe agjensi operative ne te gjithe territorin Republikes Shqiperise me miratimin e oragneve kompetente dhe jashte vendit.

Neni 5/1

Zyra Qendrore

Zyra qendrore e shoqerise tregtare eshte ne adresen: lagjia “Aqif Pasha” Elbasan, pall. 495/2, ap.1, Shk.1, Kati 3, Shqiperi. Pasuria me nr.7/440+1-1, Zona Kadastrale 8524.

Ne zbatim te nenit ligjin Nr. 129/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, shoqeria tregtare i nenshtrohet dispozitave te ketij ligji.

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Objekti i veprimtarise: Blerje shitje, mallra industriale, tekstile, import-export me shumice dhe pakice te te gjitha llojeve te konfeksioneve, lendeve te para per prodhimin e tyre, te fijeve dhe penjeve, rrobave te gatshme dhe gjysem te gatshme. tregtim te ketyre prodhimeve. Tregtim me shumice dhe me pakice te te gjithe mallrave industriale, ushqimore dhe bujqesore. Transport te mallrave dhe aksesoreve te nevojshem per paketim dhe hapjen e agjensive turistike dhe udhetimesh. Zhvillim te aktivitetit tregetar ne dyqane etj.. Import-Eksport sipas legjislacionit shqiptar etj.

Neni 7

Kohezgjatja e shoqerise

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj dhe vepron si person juridik me personalitet te plote per te vepruar. **Z.DIONIS ÇELA** emerohet si administrator dhe perfaqesues i shoqerise ne marredhenie me te tretet, per nje afat prej 5 vitesh kalendarike, duke filluar ky aafat nga data 03.12.2018 deri me date 02.12.2023 me te drejte riperteritje.

Neni 8

Të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre

Personi pergjegjes per administrimin dhe perfaqesimin e shoqerise eshte **Z.DIONIS ÇELA** me keto te dhena identifikimi:

DIONIS ÇELA, i biri i **Brahim-it** i datelindjes 17.07.1971 lindur ne polican, Skrapar dhe banues ne lagja Aqif Pasha, Elbasan, identifikuar me leternjoftimin me nr. Personal: H10717003A, leshuar me date 05.09.2010,

Kompetencat e perfaqesimit jane te plota duke i dhene tager perfaqesuesit te perfaqesojte shoqerine ne te gjitha marredheniet juridike dhe per te gjitha veprimet juridike ku nje nga palet e ketyre marredhenieve juridike apo veprimeve juridike, shfaqet shoqeria **"IMA PLANET 2018" SHPK**.

Z. DIONIS ÇELA emerohet si administrator dhe perfaqesues i shoqerise ne marredhenie me te tretet me afat prej 5 vitesh kalendarike, me te drejte riperteritje.

Neni 9

Specimenti i nenshkrimit (firmes) se personit qe perfaqeson shoqerine perpara te treteve

DIONIS ÇELA

Dionis Çela



Neni 10

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) Leke. Kapitali shoqerise perbehet nga dy kuota te cilat zoterohen nga ortaket si vijon;

- Nje kuote me vlere nominale 51.000 leke dhe qe perfaqeson 51 % te kapitalit te regjistruar te shoqerise zoterohet nga ortaku **FRENK HODAJ**,



dhe

Nje kuote me vlere nominale 49.000 leke dhe qe perfaqeson 49 % te kapitalit te regjistruar te shoqerise zoterohet nga ortakja ANILA ÇELA. Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta).

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te tretteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 11

Ndalimi i konkurrences

Ndalimi i permendur ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", mund te shfuqizohet nepermjet nje autorizimi te posacem, te dhene nga asambleja e ortakeve sipas dispozitave te nenit 36 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 12

Ne mungese te nje shfuqizimi te parashikuar nga neni 16 i ketij statuti, ndalimi i konkurrences i parashikuar ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", mbetet ne fuqi deri ne 1 (nje) vit kalendarik pas humbjes se cilesive te permendura ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901.

Neni 13

Kalimi i kuotave

1. Kushtezohet kalimi i kuotave te ortakeve te shoqerise "IMA PLANET 2018" SHPK me te drejten e parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te shoqerise, nese ka.
2. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
3. Fitimi apo kalimi i kuotave me kontrate, duhet te realizohet ne menyre te detyrueshme me akt noterial.
4. Permbajtja e ketij neni mund te ndryshohet vetem me miratimin e me shume ortakeve qe perfaqesojne me shume se 4/5 e pjeseve te kapitalit themeltar.

Neni 14

Shperndarja e fitimeve

Asambleja e Ortakeve ka te drejte te terheqin pjesen e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise.

Neni 15

Fitimi i shperndahet ortakeve ne raport me kuotat e zoteruara.



Neni 16

Te drejtat dhe detvrimet e ortakut te vetem

Asambleja e Ortakeve te shoqerise "IMA PLANET 2018" SHPK ne baze te pikes 3 te nenit 81 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", jane pergjegjes per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhte:

Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;

Ndryshimet e statutit;

Emerimin e shkarkimin e administratoreve;

Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;

Percaktimin e shperblimeve per administratoret, likuiduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar;

Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;

Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;

Pjestimin e kuotave dhe anulimi i tyre;

Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;

Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;

Nisjen e nje hetimi te posacem per parregullsite pergjate veprimeve te themelimit te shoqerise apo te ushtrimit te veprimtarise tregtare, hetim ky i cili kryhet nga nje ekspert i pavarur i fushes;

Miraton bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurise se veprimtarise dhe propozimet per shperndarjen e fitimeve, dokumente keto te paraqitura nga administratori.

Vendos per nisjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, ne perputhje me dispozitat e ligjit dhe te ketij statuti.

Vendos per likuidimin me nje procedure te pershejtuar sipas nenit 24 te ketij statuti.

Neni 17

Regjistri i vendimeve te Asamblese se Ortakeve

1- Te gjitha vendimet e marra nga asambleja e ortakeve sipas nenit 19 te ketij statuti, regjistrohen ne Regjistrin e vendimeve te shoqerise.

2- Te dhenat e regjistrit te vendimeve te asamblese se ortakeve nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

3- Regjistrohen ne vecanti vendimet per:

a- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;

b- Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

c- Investime;

ç- Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

4- Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme.

Neni 18

Rregulla per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, dhe vendim-marrjen e saj, ne rast se shoqeria ka dy ose me shume ortakë

Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.

Asamblene e Pergjithshme, kane te drejte ta therrasin:

1- Administratoret.

2- Ortaket e pakices sipas nenit 84 te ligjit nr.9901.

Asambleja e Pergjithshme thirret ne menyre te vecante:

a- Nese sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

b- Kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, pasuri te cilat kane nje vlere me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

c- Kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise, qe rezulton nga pasqyrat e fundit te certifikuara.

Ne rastet "a-" dhe "c-", te ketij neni, asamblese i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, si e varur.

Ne rastet e mesiperme (a, b, c te ketij neni), asambleja mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo duke bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

Neni 19

Menyra e thirrjes se asamblese

Asambleja e Pergjithshme thirret permes nje njoftimi me shkrese.

Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjitha ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Ne zarfin me te cilin dergohet njoftimi me shkrese apo cdo shkrese tjeter ne funksion te mbledhjes se asamblese, ne anen e jashtme te pasme te tij duhet te shkruhet detyrimisht nje permbledhje e sakte e dates se hartimit te shkreses qe gjendet ne permbajtje te letres, e titullit te kesaj shkrese, dhe e permbajtjes se njoftimit me te gjitha detajet e rendesishme qe permban letra.

Njoftimi me shkrese i dergohet ortakeve, me lajmerim marrje, ne adresat e deklaruar paraprakisht prej tyre qysh ne momentin qe shoqeria do te behet me dy ose me shume ortake.

Nese asambleja thirret nga nje administrator i cili eshte njekohesisht ortak, atehere nuk eshte e nevojshme dergimi i njoftimit te thirrjes se mbledhjes, ortakut-administrator.

Nese ekziston nje vendim gjykate per pezullimin e te drejtave te ndonjerit prej ortakeve, atehere thirren vetem ortaket e tjere me te drejta te plota dhe vendimore.

Nese nga ky vendim pezullimi, ka ngelur vetem nje ortak me te drejta ne shoqeri, dhe ky ortak eshte njekohesisht administrator, dispozitat mbi njoftimin e mbledhjes se asamblese nuk zbatohen, kur kjo mbledhje thirret nga ky administrator-ortak.

Ortaku i thirrur ne rast pamundesie absolute per pjesemarrjen ne mbledhje, mund ti drejtoje brenda 2 (dy) diteve nga marrja e njoftimit per thirrjen e asamblese se pergjithshme, administratorit apo ortakut te pakices (sipas nenit 84 te ligjit nr.9901), nje leter me shkrim ne adresen e deklaruar te administratorit apo ortakut te pakices qe ka thirrur mbledhjen, ku te shpjegoje arsyet e pamundesise se pjesemarrjes dhe te kerkoje shtyrjen e mbledhjes ne nje date te deshiruar nga ai jo me vone se 30 dite kalendarike nga marrja e njoftimit te pare per thirrjen e asamblese.

Njekohesisht eshte i detyruar te bashkengjise prova shkresore origjinale ose te noterizuara, qe mbeshtesin arsyen e mospjesemarrjes. Ne mungese te ketyre provave kerkesa per shtyrjen e mbledhjes nuk konsiderohet dhe mospjesemarrja nuk do te pengoje mbledhjen e asamblese.

Konsiderohet marrje njoftimi per efekt te ketij statuti, momenti qe sherbimi postar dergon letren tek marresi i njoftimit, ne adresat e deklaruar ne kete statut, pavaresisht dates se dorezimit ne sherbimin postar te njoftimit nga personi qe kryen njoftimin, dhe pavaresisht ne se marresi i njoftimit e merr ne dorezim letren ose e refuzon ate. Detyren dhe pergjegjesine per ti shpjeguar sherbimit postar procedurat e siperpermendura, e ka personi qe dergon njoftimin. Mosrespektimi i procedurave te njoftimit te mesiperme e ben njoftimin e pavlefshem.

Nese asambleja nuk eshte thirrur sipas rregullave te percaktuara me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane prezent ne mbledhje dhe jane dakord per te marre vendime.

Pjesemarrja e ortakeve ne mbledhjen e asamblese mund te behet e mundur edhe me mjete te ndryshme komunikimi, perfshire mjetet elektronike, me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakeve.

Neni 20

Procesverbali i mbledhjes mbahet gjithmone nga nje Noter i licensuar ne Republiken e Shqiperise, ne ambientet e zyres se Noterit te zgjedhur nga pala qe ka thirrur mbledhjen.

Ne rastet kur prezent ne mbledhjen e asamblese jane te gjithe ortaket e shoqerise, nuk eshte e nevojshme mbajtja e procesverbalit perpara noterit, por kete procesverbal e mban administratori apo ortaku i pakices i cili ka thirrur mbledhjen.

Caktohet kryetar nenshkruer i procesverbalit administratori qe e ka thirrur mbledhjen, apo ortaku sipas nenit 84 te ligjit nr.9901. Ne rastet kur pjesemarrjes ne mbledhje jane te gjithe ortaket, dhe procesverbali mbahet nga administratori apo ortaku i pakices, sipas paragrafit te mesiperem, kryetar nenshkruer caktohet ortaku me i vjeter ne moshe dhe ne rast se ky ortak perkon me mbajtesin e procesverbalit, atehere kryetar nenshkruer caktohet ortaku tjeter me i vjeter ne moshe.

Procesverbali nenshkruhet nga kryetari dhe mbajtesi i procesverbalit.

Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesemarrjesve dhe akti i thirrjes se Asamblese.

Nese ne mbledhjen e asamblese jane te gjithe ortaket e shoqerise prezent nuk eshte e nevojshme ti bashkelidhet procesverbalit akti i thirrjes se asamblese se pergjithshme.

Vertetimi i prezences se ortakeve ne mbledhjen e asamblese kryhet me vendosjen ne aktin e vecante te listes se pjesemarrjesve te shenjes se gishtit tregues te dores se djathte, te lyer me boje blu, dhe nenshkrimet te ortakut me emer, mbiemer, dhe firme, perbri shenjes se gishtit te tij.

Neni 21

Nese mbledhja e asamblese nuk respekton rigorozisht procedurat e parashikuara ne nenet 20/2 dhe 20/3 te ketij statuti, ajo nuk mund te marre asnje vendim te vlefshem.

Neni 22

Marrja e vendimeve

Ne lidhje me vendimet per:

1- Ndryshimin e statutit.

2- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar.

2- Shperndarjen e fitimeve.

4- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise asambleja vendos me te pakten $\frac{3}{4}$ e votave te ortakeve pjesemarrjes ne mbledhjen e asamblese.

Ne lidhje me vendimet e tjera, te renditura ne nenin 19 te ketij statuti, asambleja vendos me shumicen e thjeshte te votave te ortakeve pjesemarrjes.

Te gjitha vendimet e asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal, ne perputhje me kushtet dhe rregullat e percaktuara ne nenin 90 te ligjit nr.9901.

Neni 20/5

Kuorumi

Per vendimet per te cilat kerkohej shumice te cilesuar prej $\frac{3}{4}$, asambleja nuk mund te marre vendime te vlefshme nese ne mbledhje nuk jane prezent personalisht ortaket qe zoterojne te pakten me shume se gjysmen e kuotave me te drejte vote ne shoqeri.

Per vendimet qe kerkohet shumice e thjeshte, asambleja nuk mund te marre vendime te vlefshme nese ne mbledhje nuk jane prezent personalisht ortaket qe zoterojne te pakten me shume se 30 % (tridhjetë perqind) e kuotave me te drejte vote ne shoqeri.

Neni 23

E drejta e votes

Cdo kuote jep te drejten e nje vote.

Neni 24

Te drejtat dhe detyrimet e administratorit

Administratori ka te drejte dhe detyrohet te:

Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga ortakut i vetem;

Te perfaqesoje shoqerine tregtare;

Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;

Te pergatise dhe te nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurise se veprimtarise dhe propozimet per shperndarjen e fitimeve;

Te krijojë nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;

Te kryeje regjistrimet dhe te dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sipas ligjit "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Te raportoje perpara ortakut te vetem ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

Nese jane emeruar dy ose me shume administratore, keta e administrojne bashkerisht shoqerine. Asambleja e Ortakeve me vendim te vecante, mund te percaktoje qe te kete rradhe hierarkike ne administrim, nga administratore te caktuar duke specifikuar rrethanat e kesaj perpariesi ndermjet administratoreve.

Ne rast likuidimi ne gjendjen e aftesise paguese, i njofton per regjistrim QKR-se te dhenat e likuiduesve te pare dhe tagrat e tyre.

Neni 25

Shperblimi i administratoreve

Shperblimi i administratoreve percaktohet me vendim te zakonshem te asamblese se ortakeve.

Shperblimi i administratorit duhet te jete i pershtatshem dhe ne perputhje me detyrat e administratoreve dhe gjendjen financiare te shoqerise.

Nese shoqeria eshte ne veshtiresi financiare, asambleja e ortakeve mund te vendose reduktimin e shperblimit te administratoreve ne masen e pershtatshme.

Kriteret e shperblimit, shperblimi individual dhe efekti vjetor i shperblimit te administratoreve ne strukturen e kostove te shoqerise publikohen se bashku me pasqyrat financiare vjetore.

Neni 26

Emerimi i likuiduesit

Ne rast se asambleja e ortakeve vendos per likuidimin e shoqerise ne gjendjen e aftesise paguese, eshte i detyruar te caktojë likuiduesin, brenda 30 diteve pas prishjes.

Ne caktimin e likuiduesit duhet te kihet parasysh se ky caktim nuk duhet te paraqese arsye te mjaftueshme per te dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqerise mund te cenohet nga likuiduesi i caktuar.

Neni 27

Te drejtat dhe detyrat e likuiduesit

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Kufizime te caktuara per veprimtarine e likuiduesit, mund te vendosen nga asambleja e ortakeve ne aktin e emerimit te likuiduesit. Keto kufizime publikohen ne menyre elektronike sipas nenit 61 te ligjit nr.9723 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe kane efekt edhe ndaj te treteve duke u quajtur te njohura publikisht ne perputhje me nenin 12 te ligjit nr.9901.

Likuiduesi ka detyre te ftoje kreditorët e shoqerise per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e shoqerise.

Detyrat kryesore te likuiduesve jane:

Mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise.

Mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera.

Shitja e pasurive te shoqerise.

Shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e preferimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.

Kryerja e veprimeve te reja tregtare ne funksion te mbylljes se nje veprimi te paperfunduar.

Kur likuiduesit vejne re se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e pretendimeve te ngritura nga kreditorët, likuiduesi pezullon proceduren e likuidimit dhe i kerkon gjykates nisjen e procedurave te falimentimit.

Neni 28

Shperndarja e aktiveve

Pas shlyerjes se detyrimeve ndaj kreditoreve, likuiduesi i shperndan ortakeve aktivet e mbetura, me radhe preference ne favor te "IMA PLANET 2018" SHPK.

Neni 29

Likuidimi i thjeshtezuar

Me vendim te saj asambleja e ortakeve mund te vendose per likuidimin e persheptuar.

Me marrjen e ketij vendimi dhe regjistrimin e tij te rregullt ne regjistrin e vendimeve, sipas kriterëve te ketij statuti, asambleja e ortakeve eshte i detyruar te deklaroje perpara gjykates perkatese se te gjitha detyrimet e shoqerise ndaj kreditoreve jane shlyer e jane rregulluar te gjitha marredheniet me punemarresit.

Administratori i shoqerise njofton per regjitrin prane QKR-se vendimin e mesiperm. Administratori dhe ortaku i vetem jane pergjegjes solidarisht, per demin e shkaktuar nga shkelja e detyrave te tyre gjate likuidimit te thjeshtezuar.

Neni 30

Dispozita te fundit


Ky statut hyn ne fuqi me regjistrimin e tij prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Miratuar nga ortaket e vetem te shoqerise FRENK HODAJ dhe ANILA ÇELA. Garanton cdo pale te trete qe e ka hartuar dhe nenshkruar vete kete statut te shoqerise "IMA PLANET 2018" SHPK ne te gjitha faqet qe e perbejne ate. Ortaket e shoqerise FRENK HODAJ dhe ANILA ÇELA autorizojne noterën publike ILA A. PISTOLJA, mbajtese e leternjoftimit me nr. personal: I26106007T, leshuar me date 06.12.2010 te paraqitet prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit Elbasan per te kryer rregjistrimin e shoqerise dhe pajisjen me Çertifikate Rregjistrimi.


SHOQERIA "IMA PLANET 2018" SHPK

Perfaqesuar nga ortaket e shoqerise

Z. FRENK HODAJ

Zj. ANILA ÇELA







REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE DURRES

Notere: ILA A. PISTOLJA

Studio: Lagjia "Aqif Pashe Elbasani", Rr."28 Nentori", Elbasan



Nr. 2360 Rep.
Nr. 1165 Kol.

Vërtetim - Nënshkrimi

Sot me datën 03 12/2018 (dymije e tetembedhete), ditën e Hënë, para meje ILA PISTOLJA notere ne qytetin e Elbasanit me Seli si me siper, u paraqiten personalisht personat si me poshte vijon:

Z.FRENK HODAJ, me gjeneralitet: atesia: Ilir, i datelindjes 23.08.1995 lindur ne Vlore dhe banues ne Rr. Ibrahim Rugova, Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar identifikuar me pasaporten me nr.J508231071, leshuar me date 26.12.2017,

dhe

Zj. ANILA ÇELA me gjeneralitetet: atesia: Shefqet, e datelindjes 22.09.1974 lindur ne Polican, Skrapar dhe banues ne lagja Aqif Pasha, Elbasan madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar identifikuar me leternjoftimin me nr. Personal: H45922002N, leshuar me date 05.04.2011,

te cilet me konfirmuan se "Statutin e shoqerise " IMA PLANET 2018" sh.p.k si bashkangjitur e kane perpiluar prane kesaj zyre noteriale dhe e nenshkruan ate rregullisht perpara meje sipas vullnetit te tyre, te lire, te plote dhe te pavesuar.

Une noterja i vertetoj nenshkrimin e tyre sipas Ligjit nr. 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine".

NOTERE
ILA A. PISTOLJA

